

# RELACIONI PËR PROCESIN E ORGANIZIMIT TË SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (TË PËRKOHSHËM)

*Zhvilluar më datë 7.12.2018*

## I. Hyrje

Sot më datë 7 dhjetor 2018, ora 10:00, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit z. Gramoz Ruçi, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d, nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe të Urdhrit nr.2, datë 03.12.2018, “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm)”, urdhrit nr.3, datë 3.12.2018, “Për caktimin e datës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm)”, në ambientet e Kryesisë së Kuvendit, salla “Pjetër Arbënor”, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm).

## II. Vendimarrja e Kryetarit të Kuvendit përpara datës së hedhjes së shortit:

Me shkresën nr.3479 Prot., datë 23.11.2018, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar pamundësinë për ushtrimin e kompetencës së tij kushtetuese për organizimin e procedurës së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sipas nenit 149/d të Kushtetutës dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nëse Presidenti nuk arrin të zgjedhë anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, brenda datës 5 Dhjetor, Kryetari i Kuvendi i zgjedh ata (anëtarët e KED) me short brenda datës 10 Dhjetor të atij viti kalendarik.

Në përfundim të shkresës drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Presidenti i Republikës shprehet se: *“Duke vlerësuar rrethanat e faktit ku precedenti i krijuar mbi këtë çështje është aplikuar dhe krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës vlerëson se edhe për këtë vit, Kuvendi është i vetmi organ që ka mundësinë dhe detyrimin për ta zgjidhur këtë situatë.”...*

- ***Veprimet paraprake dhe aktet e nxjerra nga Kryetari para datës së hedhjes së shortit***
- Kërkesa drejtuar institucioneve që ngarkon ligji për përcjelljen e listave

Kryetari i Kuvendit, me qëllim zbatimin e detyrimit dhe kompetencës kushtetuese për hedhjen e shortit për krijimin e organit të KED, nisi procedurat për organizimin e shortit, në përputhje me afatet kushtetuese dhe ligjore.

Me shkresën nr. 3732/4, datë 03.12.2018, Kuvendi i Shqipërisë i është drejtuar zyrtarisht, Këshillit të Lartë të Drejtësisë për përcjelljen e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet për anëtar të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi (të përkohshëm).

Në përgjigje të kërkesës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr.3427/1, datë 04.12.2018, paraqiti listat me emrat e gjyqtarëve të Gjykatave të Apelit dhe të gjykatave administrative, që plotësojnë kushtet për anëtar të KED.

Ndërkohë që, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, dhe Prokuroria e Përgjithshme kishin përcjellë më parë në adresë të institucionit të Presidentit të Republikës listat përkatëse me kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore për të qënë anëtarë të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi.

**- Aktet e nxjerra :**

Në zbatim të pikës 3 të nenit 149/d, pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës, si dhe nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Kryetari i Kuvendit miratoi këto akte:

- Urdhrin nr. 2, datë 03.12.2018, “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi (të përkohshëm)”. Ky Urdhër u publikua në faqen zyrtare të Kuvendit, si dhe në Fletoren Zyrtare, nr.171, datë 04.12.2018.
- Urdhrin nr. 3, datë 03.12.2018, të Kryetarit të Kuvendit “Për caktimin e datës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi (të përkohshëm)”.

Kryetari i Kuvendit, njoftoi zyrtarisht, për datën dhe orën e organizimit të shortit:

- Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetarin e Gjykatës së Lartë;
- Prokurorin e Përgjithshëm;
- Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

Në mbështetje të dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” Avokati i Popullit, u ftua për të marrë pjesë në këtë short në cilësinë e vëzhguesit.

Gjithashtu në procedurën e hedhjes së shortit u ftuan të merrnin pjesë:

- Përfaqësues të grupeve parlamentare;
- Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
- Përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe organizatat ndërkombëtare;
- Mediat.

Në kuadër të transparencës, njoftimi, gjithashtu, u publikua në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë në internet, në datën 03.12.2018.

Në zbatim të pikës 3 të Urdhrit nr. 2, datë 03.12.2018, të Kryetarit të Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 409, datë 05.12.2018 ngriti Sekretariatit Teknik, i cili organizoi procedurat e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm).

### **III. Listat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji dhe që janë përcjellë zyrtarisht nga institucionet përkatëse është si vijon:**

*Lista e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, dërguar me shkresën nr. 398, datë 15.11.2018, me këtë përbërje:*

1. z. Bashkim Dedja
2. znj. Vitore Tusha

*Lista e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, dërguar me shkresën 3982, datë 13.11.2018, me këtë përbërje:*

1. z. Edmond Islamaj
2. z. Ardian Dvorani
3. z. Medi Bici

*Lista e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, depozituar në Kuvend, me shkresën nr.3054, datë 14.11.2018, me këtë përbërje:*

1. znj. Arta Marku

*Lista e prokurorëve nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit depozituar në Kuvend, me shkresën nr. 3054, datë 14.11.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, me këtë përbërje:*

1. znj. Fatjona Memçaj

*Lista e gjyqtarëve të Gjykatave të Apelit dhe Gjykatave Administrative depozituar në Kuvend, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr.3247/1 , datë 4.12.2018, me këtë përbërje:*

*Gjyqtarët e gjykatave të apelit:*

1. z. Andi Civici
2. z. Artur Kalaja
3. znj. Edlira Petri
4. znj. Elbana Lluri
5. z. Fatri Islamaj
6. z. Desart Avdulaj
7. z. Enton Dhimitri
8. z. Olsi Xhavella
9. z. Aleks Nikolli
10. znj. Brikena Lubonja (Ukperaj)
11. znj. Klodiana Gjyzari
12. znj. Margarita Buhali
13. znj. Albana Boksi
14. z. Gurali Brahimllari

*Gjyqtarët e gjykatave administrative:*

1. znj. Altina Nasufi
2. z. Amarildo Laçi
3. z. Artur Malaj
4. znj. Bernina Kondi
5. znj. Blerona Hasa

6. znj. Fjoralba Prifti
7. z. Kastriot Selita
8. znj. Rilinda Selimi
9. znj. Klodiana Veizi (Mema)
10. znj. Elda Vrioni
11. z. Erarbër Madhi
12. z. Eriol Roshi
13. z. Gentian Hamiti
14. z. Gentian Medja
15. znj. Gentiana Qeseja (Muçaj)
16. znj. Nafije Curri (Hasko)

#### IV. Procedura e hedhjes së shortit

##### **Prania e përfaqësuesve të institucioneve në hedhjen e shortit:**

Sekretariati Teknik verifikoi praninë e përfaqësuesve të institucioneve të sipërpërmendura. Nga verifikimi rezultoi:

- Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca rezultoi e pranishme
- Nga Gjykata Kushtetuese: (z. *Aleksandër Toma, Drejtor i Kabinetit të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese*)
- Nga Gjykata e Lartë: (z. *Miran Kopani, Drejtor Kabineti i Kryetarit të Gjykatës së Lartë*)
- Nga Prokuroria e Përgjithshme: (z. *Adnan Xholi, Drejtor i Drejtorisë Gjyqësore*)
- Nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, (z. *Vildan Kaloshi, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit të Mbledhjeve të KLD-së*).

Gjithashtu, rezultuan të pranishëm:

z. Taulant Balla, znj. Vasilika Hysi dhe z. Ulsi Manja, përfaqësues të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, z. Oerd Bylybashi, përfaqësues i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare si dhe media.

Sekretariati Teknik kishte vënë në dispozicion të të pranishmëve dosje me korrespondencën përkatëse, listën e kandidatëve si dhe materiale të tjera të lidhur me procesin e hedhjes së shortit.

I gjithë procesi i hedhjes së shortit u regjistrua në audio dhe video dhe u zhvillua në transmetim direkt nga media.

## **Pretendimet për hedhjen e shortit**

Para fillimit të procedurës për hedhjen e shortit, përfaqësuesi i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, z. Oerd Bylykbashi, duke referuar shkresën e Presidentit të Republikës, u shpreh se procesi i iniciuar nga Kryetari i Kuvendit po kryhet në një boshllëk kushtetues dhe ligjor dhe se në mungesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, po përdoren dispozita tranzitore që e kanë humbur fuqinë e tyre. Në përfundim të fjalës së tij, z.Bylykbashi kërkoi tërheqjen nga shorti dhe plotësimin e boshllëkut ligjor që KED-ja të nisë funksionimin në mënyrë kushtetuese.

Kryetari i Kuvendit, solli në solli në vëmendjen e të pranishmëve, faktin se letra e Presidentit të Republikës është shqyrtuar mbështetur në të gjithë kornizën kushtetuese dhe ligjore duke u konsultuar njëkohësisht me misionet ndërkombëtare, që kanë asistuar reformën në sistemin e drejtësisë dhe vetëm pas këtij procesi janë nxjerrë urdhrat përkatës për hedhjen e shortit nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare ishin prezent gjatë gjithë procedurës së hedhjes së shortit, deri në shpalljen finale të fituesve të përzgjedhur prej shortit të hedhur. Gjatë procedurës të zhvillimit të shortit nga ana e Avokates së Popullit, u pretendua se institucionet kanë ndjekur standarde të ndryshme në hartimin e listave të kandidatëve për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

### **V. Procedura e hedhjes së shortit**

Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi, asistuar nga Sekretariati Teknik zhvilloi procedurën e përgatitjes dhe të hedhjes së shortit sipas rregullave të përcaktuara në Urdhrin nr.2, datë 03 Dhjetor 2018.

#### **▪ Shorti për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese**

Nga lista që është dërguar nga Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. 398, datë 15.11.2018, rezulton se janë 2 kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Sipas parashikimeve të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi nga Gjykata Kushtetuese zgjidhen 2 anëtarë të përhershëm si dhe 1 anëtar zëvendësues.

Në këto kushte nga Kryetari i Kuvendit u konstatua se procedura e shortit për zgjedhjen e dy anëtarëve të KED nga Gjykata Kushtetuese nuk mund të zhvillohet, pasi për dy vende vakante ka vetëm 2 kandidatura, që në këtë rast, do të konsiderohen automatikisht (*ipso jure*) anëtarë të zgjedhur të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pra, anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, rezultojnë kandidatët e propozuar, znj. Vitore Tusha dhe z. Bashkim Dedja.

Për shkak të numrit të kandidaturave të sjella, u konstatua se nuk mund të zhvillohej as procedura e shortit për zgjedhjen e anëtarit zëvendësues që i përket Gjykatës Kushtetuese dhe për rrjedhojë, për këtë institucion nuk do të ketë anëtar zëvendësues.

- **Shorti për anëtar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë**

Sipas parashikimeve të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi nga Gjykata e Lartë zgjidhet 1 anëtar i përhershëm si dhe 1 anëtar zëvendësues. Nga lista që është dërguar nga Gjykata e Lartë me shkresën nr. 3982, datë 13.11.2018, rezulton se janë tre kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Kryetari i Kuvendit ftoi Sekretariatit të fillojë procedurën për hedhjen e shortit.

*(Veprimet e Sekretariatit Teknik: U lexuan një e nga një emrat e 3 kandidatëve, të pasqyruara në shirita letre. Çdo shirit u fut në gogël dhe goglat u hodhën në kuti. Të gjitha veprimet u kryen përpara kamerave. Anëtarja e Sekretariatit e ngarkuar për tërheqjen e goglës, pasi rrotulloi kutinë, tërhoqi goglën e parë. Hapi goglën, dhe më zë të lartë drejtuar nga kamerat deklaroi emrin e anëtarit të zgjedhur: “Ardian Dvorani”.)*

Kryetari i Kuvendit sqaroi se tërheqja e goglës së dytë është për anëtarin zëvendësues nga Gjykata e Lartë.

*(Veprimet e Sekretariatit Teknik: Anëtarja e Sekretariatit e ngarkuar për tërheqjen e goglës, pasi rrotulloi kutinë me gogla, tërhoqi goglën e dytë. Hapi goglën, dhe me zë të lartë, drejtuar nga kamerat, deklaroi emrin e anëtarit të zgjedhur: “Medi Bici”.)*

- **Shorti për anëtar Këshilli të Emërime në Drejtësi (të përkohshëm) nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme**

Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën zyrtare nr.3054, datë 14.11.2018, ka paraqitur vetëm një kandidaturë nga Prokuroria e Përgjithshme që plotëson kushtet ligjore.

Sipas ligjit, në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi zgjidhet 1 anëtar i përhershëm nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe 1 anëtar zëvendësues.

Në këto kushte, Kryetari i Kuvendit konstatoi se procedura e shortit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit që i përket kësaj kategorie nuk mund të zhvillohet, pasi ka vetëm një kandidat të propozuar që në këtë rast, do të konsiderohet automatikisht (*ipso jure*) anëtar i zgjedhur i Këshillit.

Pra, anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton kandidatja e vetme e propozuar, prokurorja Arta Marku.

Për shkak të mungesës së kandidaturave të tjera nuk mund të zhvillohet shorti për anëtarin zëvendësues nga Prokuroria e Përgjithshme.

- **Shorti për anëtar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga prokurorët në zyrat e Prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit**

Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën zyrtare nr.3054, datë 14.11.2018, ka paraqitur 1 kandidaturë nga prokurorët e zyrave të prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit.

Në këto kushte, duke qenë se ligji parashikon që në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi të zgjidhen 2 anëtarë nga zyrat e prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit, procedura e shortit për zgjedhjen e 2 anëtarëve nuk mund të zhvillohet, pasi ka vetëm një kandidaturë, që në këtë rast do të konsiderohet automatikisht (*ipso jure*) anëtare e zgjedhur e Këshillit.

Pra, anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga prokurorët e zyrave të prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit rezulton prokurorja Fatjona Memçaj.

Për shkak të mungesës së kandidaturave të tjera nuk mund të zhvillohet shorti për anëtarin zëvendësues nga prokurorët e zyrave të prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit.

- **Shorti për anëtar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga gjyqtarët e Gjykatave të Apelit**

Nga lista që është dërguar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr.3247/1, datë 4.12.2018, rezulton se nga gjykatat e apelit janë 14 kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Sipas parashikimeve të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nga gjyqtarët e Gjykatave të Apelit zgjidhen 2 anëtarë në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si dhe 1 anëtar zëvendësues.

Kryetari i Kuvendit ftoi Sekretariatit të fillojë procedurën për hedhjen e shortit.



*(Veprimet e Sekretariatit Teknik: U lexuan një e nga një emrat e 14 kandidatëve të pasqyruar në shirita letre. Çdo shirit u fut në gogël dhe goglat u hodhën në kuti. Të gjitha veprimet u kryen përpara kamerave. Anëtarja e Sekretariatit e ngarkuar për tërheqjen e goglës, pasi rrotulloi kutinë, tërhoqi goglën e parë. Hapi goglën, dhe më zë të lartë drejtuar nga kamerat deklaroi: emrin e anëtarit të zgjedhur “Fatri Islamaj”. Më pas tërhoqi goglën e dytë për anëtarin tjetër. Hapi goglën, dhe më zë të lartë drejtuar nga kamerat deklaroi emrin e anëtarit të zgjedhur: “Margarita Buhali”.)*

Kryetari i Kuvendit sqaroi se tërheqja e goglës së tretë është për anëtarin zëvendësues.

*(Veprimet e Sekretariatit Teknik: Anëtarja e Sekretariatit e ngarkuar për tërheqjen e goglës, pasi rrotulloi kutinë me gogla, tërhoqi goglën e tretë. Hapi goglën, dhe me zë të lartë, drejtuar nga kamerat, deklaroi emrin e anëtarit të zgjedhur: “Gurali Brahimllari”.)*

- **Shorti për anëtar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) nga gjyqtarët e Gjykatave Administrative**

Nga lista që është dërguar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr.3247/1 Prot., datë 4.12.2018, rezulton se nga gjykatat administrative janë 16 kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sipas parashikimeve të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nga gjyqtarët e gjykatave administrative zgjidhet 1 anëtar në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si dhe 1 anëtar zëvendësues.

Kryetari i Kuvendit ftoi Sekretariatit të fillojë procedurën për hedhjen e shortit.

*(Veprimet e Sekretariatit Teknik: U lexuan një e nga një emrat e 16 kandidatëve të pasqyruar në shirita letre. Çdo shirit u fut në gogël dhe goglat u hodhën në kuti. Të gjitha veprimet u kryen përpara kamerave. Anëtarja e Sekretariatit e ngarkuar për tërheqjen e goglës, pasi rrotulloi kutinë, tërhoqi goglën. Hapi goglën, dhe më zë të lartë drejtuar nga kamerat deklaroi emrin e anëtarit të zgjedhur: “Eriol Roshi”.)*

Kryetari i Kuvendit sqaroi se tërheqja e goglës së dytë është për anëtarin zëvendësues.

*(Veprimet e Sekretariatit Teknik: Anëtarja e Sekretariatit e ngarkuar për tërheqjen e goglës, pasi rrotulloi kutinë me gogla, tërhoqi goglën e dytë. Hapi goglën, dhe me zë të lartë, drejtuar nga kamerat, deklaroi emrin e anëtarit të zgjedhur: “Klodiana Veizi (Mema)”.)*

## VI. Shpallja e rezultatit

Në përfundim të hedhjes së shortit, Kryetari i Kuvendit , shpalli emrat e tetë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm), të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, si vijon:

**Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm):**

<b>Nr.</b>	<b>Emër/Mbiemër</b>	<b>Institucioni</b>
1.	Vitore Tusha	<i>Nga Gjykata Kushtetuese</i>
2.	Bashkim Dedja	<i>Nga Gjykata Kushtetuese</i>
3.	Ardian Dvorani	<i>Nga Gjykata e Lartë</i>
4.	Arta Marku	<i>Nga Prokuroria e Përgjithshme</i>
5.	Fatri Islamaj	<i>Nga Gjykatat e Apelit</i>
6.	Margarita Buhali	<i>Nga Gjykatat e Apelit</i>
7.	Fatjona Memçaj	<i>Nga zyrat e Prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit</i>
8.	Eriol Roshi	<i>Nga Gjykatat Administrative</i>

Nga zyrat e Prokurorisë të Apelit, u zgjodh (ipso jure) vetëm një anëtar për shkak se nga shkresa e dërguar zyrtarisht nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme është përcjellë vetëm një kandidaturë për anëtar të KED-së ( të Përkohshme) nga zyrat e prokurorisë të Apelit.

**Anëtarët zëvendësues për secilin institucion të parashikuar në ligjin 115/2016:**

<b>Nr.</b>	<b>Emër/Mbiemër</b>	<b>Institucioni</b>
1.	<i>Medi Bici</i>	<i>Nga Gjykata e Lartë</i>
2.	<i>Gurali Brahimllari</i>	<i>Nga gjykatat e apelit</i>
3.	<i>Klodiana Veizi (Mema)</i>	<i>Nga gjykatat administrative</i>

*Nga Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme si dhe nga zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit nuk ka anëtar zëvendësues.*